



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 shkurt 2022  
Nr.ref.:RK 1939/22

## VENDIM PËR REFUZIM

né

**rastin nr. KI178/20**

Parashtrues

**Srboljub, Srgjan, Tomo dhe Sllavisha Dakiq**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 341/2019, të 9 janarit 2020**

## **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhami Rexhepi, gjyqtar

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Srboljub, Srgjan, Tomo dhe Sllavisha Dakiq nga Komuna e Pejës, të përfaqësuar nga Naser Husaj, avokat nga Peja (në tekstin e mëtejmi: parashtruesit e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [Rev.nr.341/2019] të 9 janarit 2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesit e kërkesës Aktgjyimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e kanë pranuar më 21 tetor 2020.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilët pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesve të kërkesës të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), mirëpo pa specifikuar ndonjë nga të drejtat që parashihen në Kushtetutë.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridikioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 24 nëntor 2020, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
7. Më 30 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrties, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gérxhaliu Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 4 dhjetor 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kerkoi nga ai që të dorëzojë autorizimin që dëshmon se ai i përfaqëson parashtruesit e kërkesës.
9. Më 23 dhjetor 2020, përfaqësuesi i parashtruesve dorëzoi në gjykatë autorizimin për përfaqësim.
10. Më 23 shkurt 2021, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
11. Më 23 shkurt 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të parashtruesve dhe Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) dhe kerkoi nga ta që të dorëzojnë fletkthesën që dëshmon se kur parashtruesit e kanë pranuar Aktgjykin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 341/2019, të 9 janarit 2020.
12. Më 5 mars 2021, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletkthesën që dëshmon se kur parashtruesit e kanë pranuar Aktgjykin e Gjykatës Supreme.

13. Më 17 maj 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të parashtruesve dhe nga ai kërkoi që të sqaron saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se u janë cenuar parashtruesve të kërkesës.
14. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershori 2021.
15. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
16. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit GJR.KI178/20, emëroi Gjyqtarin Nexhmi Rexhepi si gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
17. Më 14 qershori 2021, në Gjykatë është rikthyer zarfi sëbashku me shkresën drejtar përfaqësuesit të parashtruesve, me mbi shkrimin se ai ndodhet në burg.
18. Më 26 qershori 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares së Gjykatës Kushtetuese.
19. Më 13 korrik 2021, Gjykata ia dërgoi një shkresë parashtruesve të kërkesës duke kerkuar nga ta që të cekin dhe sqarojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar.
20. Më 29 korrik 2021, në Gjykatë dorëzoi një shkresë avokati M.H dhe i cili paraqitet si përfaqësues i parashtruesve, ku kérkon që të i shtyhet afati i përgjigjes në shkresën e 13 korrikut 2021, për shkak se siç thotë ai, derisa të merren shkresat e lëndës nga avokati Naser Husaj i cili ndodhet në burg.
21. Më 3 gusht 2021, avokati M.H sjelli në Gjykatë autorizimin për përfaqësim të nënshkruar vetëm nga parashtruesi Srboljub Dakiq.
22. Më 10 shtator 2021, Gjykata ia dërgoi një shkresë avokatit M.H dhe nga ai kërkoi që të sjellë në Gjykatë autorizimin që dëshmon që ai i përfaqëson të gjithë parashtruesit, si dhe e njoftoi se i shtyhet afati edhe për 7 (shtatë) ditë që të përgjigjet në shkresën e Gjykatës.

23. Më 21 shtator 2021, avokati M.H sjelli në Gjykatë një shkresë përmes të cilës shpjegoi se nuk kishte mundur që të i sigurojë shkresat e lëndës nga avokati Naser Husaj, për shkak se zyrja ishte e bllokuar. Autorizimin e kërkuar nga Gjykata nuk e kishte sjellur.
24. Më 1 tetor 2021, avokati Naser Husaj dorëzoi në Gjykatë një autorizim për përfaqësim të nënshkruar nga të gjithë parashtruesit.
25. Më 7 tetor 2021, avokati Naser Husaj dorëzoi një shkresë në Gjykatë, përmes të cilës njoftoi Gjykatën se kishte qenë në burg dhe se atij i është ndaluar ushtrimi i profesionit të avokatit.
26. Më 13 tetor 2021, Gjykata ia dërgoi një shkresë parashtruesve të kërkesës, ku iu rikujo se pas kërkesës së Gjykatës drejtuar juve që të sqaroni se cilat të drejta dhe liri pretendoni se u janë cenuar, Gjykata ka pranuar një shkresë sëbashku me një autorizim nga avokati M.H i cili autorizim ishte i nënshkruar vetëm nga njëri parashtrues përkatësisht Srboljub Dakiq. Po ashtu Gjykata kishte pranuar edhe një autorizim tjetër nga avokati Naser Husaj. Lidhur me këtë Gjykata kërkoi që të sqarojnë se cili nga avokatët i përfaqëson para Gjykatës, dhe të bashkëngjisin autorizimin e vlefshëm.
27. Më 29 tetor 2021, avokati Naser Husaj dërgoi në Gjykatë një shkresë, ku thekson se atij me vendim të gjykatës i është ndaluar ushtrimi i profesionit të avokatit ku ndër të tjera pohon se “*jam suspenduar deri më datë 22.09.2022 dhe nuk kamë të drejtë të përfaqësoj e as të mbroj derisa të kaloj kjo ndalës*”. Tujje ai thekson se tash ka regjistruar agjensionin për patundshmëri dhe punë juridike, dhe se avokati M.H nuk është përfaqësues i parashtruesve por është ky vet.
28. Më 19 janar 2022, Kolegji shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

## Përbledhja e fakteve

### *Përbledhja e fakteve lidhur me procedurën e parë për vërtetimin e pronësisë*

29. Bazuar në shkresat e lëndës, paraardhësi i parashtruesve të kërkesës i ndjeri S.D, më 1 tetor 1995, kishte lidhur kontratë për blerjen e ngastratave kontestuese me nr.2186/6, nga fleta poseduese nr.268 zk. Vitomiricë dhe ngastrën 2186/10 fleta poseduese nr.4 zk. Vitomiricë, e që e përbëjnë sipërfaqen e përgjithshme prej 3628 m<sup>2</sup>, të cilat ngastra në bazë të aktvendimit 219/92 të datës 09.04.1993, kanë kaluar në pronësi të ndjerës R.M, dhe e cila kishte lidhur kontratë të shitblerjes së këtyre patundshmërive me paraardhësin e parashtruesve të kërkesës S.D. Kontrata origjinale ishte asgjësuar me rastin e djegjes së shtëpisë, mirëpo me vonë të njëjtë kishin lidhur kontratë e cila nuk është origjinal mirëpo zëvendësim i kontratës së mëparshme.
30. Paraardhësi i parashtruesve të kërkesës S.D kishte parashtruar padi ndaj të paditurës R.M, për vërtetimin e pronësisë në bazë të kontratës mbi shitblerjen, për ngastrat 2186/6, me kulturë të klasit të III, në sipërfaqe prej 1300 m<sup>2</sup>,

ngastrës nr.2186/2, me kulturë shtëpi dhe oborr e klasit III, në sipërfaqe prej 1162 m<sup>2</sup>, ngastrës me numër 2186/5 me kulturë arë të klasit III, në sipërfaqe prej 740 m<sup>2</sup>, ngastrës me numër 2186/10 me kulturë shtëpi dhe oborr në sipërfaqe prej 426 m<sup>2</sup>, dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia njoh të drejtën e pronësisë në pataundshmëritë e lartëcekura dhe ti lejojë që të regjistrohet në Drejtorinë Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës në Pejë (në tekstin e mëtejmë: DGJKP) në emër të tij.

31. Më 27 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) përmes Aktgjykit [C.nr.1011/2007], kishte vërtetuar se paditësi S.D është pronar në bazë së shitblerjes se ngastrave të lartëcekura dhe detyroi të paditurën që ta njoh këtë të drejtë paditësit dhe të lejojë të regjistrohet në DGJKP në Pejë.

*Faktet lidhur me propozimin për përsëritje të procedurës*

32. Sipas shkresave të lëndës, në një datë të paspecifikuari, i autorizuari i të paditurës R.M kishte parashtruar propozim për përsëritje të procedurës pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut).
33. Më 12 dhjetor 2011, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [Ac.nr.96/2011] (i) lejoi përsëritjen e procedurës kontestimore e përfunduar me aktgjykim në bazë të pranimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.1011/207 të 27 nëntorit 2007; (ii) anuloi aktgjykin në bazë të pranimit dhe (iii) vendosi që kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.

*Përbledhja e fakteve sa i përket masës së përkohshme*

34. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës Srboljub Dakiq kishte paraqitur propozim për lëshimin e masës së përkohshme për sigurimin e kërkesëpadisë derisa të vendoset nga ana e gjykatës lidhur me të, pranë Gjykatës Komunale.
35. Më 26 maj 2012, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [C.nr.743/11] aprovoi propozimin e parashtruesit Srboljub Dakiq me të cilin caktoi masën e përkohshme për sigurimin e kërkesëpadisë.
36. Në një datë të pasaktësuar, B.M si trashëgimtar i të ndjerës R.M parashtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut.
37. Më 14 shtator 2012, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [ Ac.nr.383/2012] refuzoi si të pabazuar ankesën e B.M dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale.
38. Në një datë të pasaktësuar, B.M paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut.
39. Më 9 korrik 2013, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.341/2012] refuzoi si të palejueshëm revizionin e B.M paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut.

*Faktet lidhur me padinë për vërtetimin e pronësisë parashtruar nga parashtruesit e kërkesës*

40. Pas vdekjes së paraardhësit të parashtruesve të kërkesës, paditësit S.D, parashtruesit e kërkesës parashtrojnë padi kundër B.M trashëgimtar i të ndjerës R.M, pranë Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), me të cilën kerkuan që të vërtetohet që të njëjtë janë pronar nga baza e shitblerjes të ngastrave kadastrale të përmendura me lartë.
41. Më 11 korrik 2014, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.1149/2013] (i) refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës; (ii) detyroi parashtruesit e kërkesës që të paditurit B.M në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajnë shumën prej 3.430 euro, dhe (iii) është lënë në fuqi aktvendimi C.nr.743/2011 i 26 majit 2012, me të cilin ishte caktuar masa e përkohshme për sigurimin e kërkesëpadisë, deri sa vendimi i shkallës së parë të mos bëhet i formës së prerë.
42. Në një datë të pa saktësuar, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë pranë Gjykatës së Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.
43. Më 29 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.3864/2014] refuzoi si të pabazuar ankesën e përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore, C.nr.1149/2013 të 11 korrikut 2014.
44. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës parashtruan revizion pranë Gjykatës Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që aktgjykimet e gjykatave te shkallës së parë dhe dytë të ndryshohen dhe të aprovohet kërkesëpadia e tyre si e bazuar, apo të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim.
45. Më 9 janar 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.341/2019] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesve të kërkesës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

### **Pretendimet e parashtruesve të kërkesës**

46. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë cekur në mënyrë specifike ndonjë të drejtë të garantuar me Kushtetutë, për të cilën ata pretendojnë se i janë shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev.nr.341/2019, të 9 janarit 2020.
47. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të shpallë të pavlefshme të tri Aktgjykimet e Gjykatave të rregullta.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

48. Gjykata fillmisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

49. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

50. Gjykata i referohet edhe nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit, që parasheh:

Neni 22  
[Procedimi i kërkesës]

*“[...]*

*4. Nëse kërkesa [...] nuk është e [...] kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të [...] plotësuar kërkesën [...]*

*[...].”*

51. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili specifikon:

*[...]*

*“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:*

*[...]*

*(e) mbrojtjen juridike të kërkuar;*

*[...]*

*(g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe*

*(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës;*

*(3) Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë bashkë me kërkesë, autorizim të vlefshëm.*

*[...].”*

52. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësish se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

53. Andaj, në vlerësimin nëse parashtruesit e kërkesës i plotësojnë kriteret kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kërkesës së tyre, Gjykata rikujton se

neni 48 i Ligjit specifikisht detyron parashtruesit e kérkesave që të qartësojnë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë dhe që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë të jenë cenuar. Ndërsa, rregulli 32 (2) (e), (q) dhe (h) të Rregullores së punës parashë që kérkesa e parashtruesve të përbajë edhe mbrojtjen juridike të kérkuar, arsyetimin procedural dhe substantiv të kérkesës si dhe informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

54. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se kérkesën e parashtruesve të kérkesës e kishte pranuar më 24 nëntor 2020. Duke marrë parasysh që kérkesa nuk ishte e kompletuar, pasi që parashtruesit nuk kishin cekur dhe as sqaruar se cilat të drejta kushtetuese pretendojnë se u ishin shkelur. Gjykata, kérkoi nga përfaqësuesi i parashtruesve të kérkesës që të cek dhe sqarojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se u janë cenuar.
55. Më 14 qershor 2021, zarfi sëbashku me shkresën drejtar përfaqësuesit të parashtruesve është rikthyer në Gjykatë me mbi shkrimin se avokati N.H ndodhet në burg. Pasi që përfaqësuesi i parashtruesve të kérkesës ndodhej në burg, më 13 korrik 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë parashtruesve të kérkesës ku kérkoi nga ta të cekin dhe sqarojnë saktësisht se cila të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar. Parashtruesit e kérkesës fare nuk u përgjigjen në shkresën e Gjykatës, por në emër të njërit nga parashtruesit përkatësisht Srboljub Dakiq u përgjigj avokati M.H i cili kérkoi nga Gjykata që të i shtyhet afati i përgjigjes në shkresën e 13 korrikut 2021, për shkak se siç thotë ai, derisa të merren shkresat e lëndës nga avokati Naser Husaj i cili ndodhet në burg. Më 10 shtator 2021, Gjykata ia dërgoi një shkresë avokatit M.H dhe nga ai kérkoi që të sjellë në Gjykatë autorizimin që dëshmon që ai i përfaqëson të gjithë parashtruesit, si dhe e njoftoi se i shtyhet afati edhe për 7 (shtatë) ditë që të përgjigjet në shkresën e Gjykatës. Edhe pas shkresës së dytë avokati M.H nuk përgjigjet pyetjes së Gjykatës, por në shkresën e tij thekson se nuk kishte mundur që të i sigurojë shkresat e lëndës nga avokati Naser Husaj, për shkak se zyrja ishte e bllokuar, po ashtu autorizimin e kérkuar nga Gjykata nuk e kishte sjellur. Pas kësaj, avokati Naser Husaj në Gjykatë dorëzoi një autorizim për përfaqësim të nënshkruar nga të gjithë parashtruesit.
56. Pas gjithë këtyre korrespondecave siç janë përmendur më lartë, në mënyrë të qartësimit më tutje, Gjykata më 13 tetor 2021, ia dërgoi një shkresë parashtruesve të kérkesës, ku iu rikujo se pas kérkesës së Gjykatës drejtar atyre që të sqarojnë se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar, Gjykata ka pranuar një shkresë sebashku me një autorizim nga avokati M.H i cili autorizim ishte i nënshkruar vetëm nga njëri parashtrues përkatësisht Srboljub Dakiq. Po ashtu Gjykata kishte pranuar edhe një autorizim tjetër nga avokati Naser Husaj. Lidhur me këtë Gjykata kérkoi nga parashtruesit që të sqarojnë se cili nga avokatët i përfaqëson para Gjykatës, dhe të bashkëngjisin autorizimin e vlefshëm.
57. Edhe pas shkresës së 13 tetorit 2021, Gjykata nuk mori ndonjë përgjigje nga ana e parashtruesve të kérkesës. Mirëpo pranoi një shkressë nga ana e avokatit Naser Husaj, ku ndër të tjera ai theksoi se atij me vendim të gjykatës i është ndaluar ushtrimi i profesionit të avokatit ku siç thekson “*jam suspenduar deri më datë 22.09.2022 dhe nuk kamë të drejtë të përfaqësoj e as të mbroj* derisa

*të kaloj kjo ndalës*". Ndër të tjera ai thekson se tash ka regjistruar agjensionin për patundshmëri dhe punë juridike, dhe se avokati M.H nuk është përfaqësues i parashtruesve por është ky vet. Sa i përket kërkesës së Gjykatës që të cekën dhe sqarohen të drejtat dhe liritë të cilat pretendohen se iu janë cenuar parashtruesve të kërkesës, ai më tej thekson vetëm se parashtruesve i është bërë e padrejtë e madhe.

58. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se përkundër kërkesave specifike të Gjykatës, parashtruesit e kërkesës: i) nuk kishin specifikuar të drejtat e tyre që pretendojnë se u janë cenuar sipas Kushtetutës; si dhe iii) nuk i kishin qartësuar se cili nga avokatët i përfaqëson para Gjykatës, kur dihet se avokati M.H kishte sjell një autorizim të nënshkruar nga vetëm njeri parashtrues, ndërsa Naser Husaj i ishte ndaluar veprimtaria me vendim gjyqësor, dhe nuk kishte të drejtë përfaqësimi, siç thekson edhe ai vetë në shkresën e dorëzuar në Gjykatë më 29 tetor 2021.
59. Andaj, në bazë të Rregullores së saj të punës, Gjykata nëse konstaton se kërkesa është e paplotë ose e paqartë mund të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet rregullit 35 të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

#### Rregulli 35

[Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

*"35 (5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën, [...]."*

60. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesve të kërkesës (shih rastet e Gjykatë Kushtetuese: KI72/19, parashtrues Amir Hamza, Vendim për Refuzim të Kërkesës, i 10 tetorit 2019, paragrafi 27; KI137/20, parashtrues Ali Latifi si përfaqësues i pretenduar i M.S., Vendim për refuzimin e kërkesës, i 11 nëntorit 2020, paragrafi 24; KI34/21, parashtrues Skender Murseli, Vendim për Refuzim, i 17 majit 2021, paragrafi 28).
61. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve të kërkesës nuk i përbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak të mos kompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 21, 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 32 (2) (e) dhe (h) të Rregullores së punës.
62. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22.4 dhe 48 dhe të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 32 (2) (e) dhe (h) dhe 35 (5) të Rregullores së punës, më 19 janar 2022, njëzëri

## VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Resa Caka Nimani